



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 311/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së flamujve mbi rrugët publike për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë kështu që subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Dardanë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 22. 10. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 20 tetor 2013 në rrugën “Skenderbeu” në Dardanë anëtarë të AKR-së, kanë vendosur flamuj mbi rrugë publike, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika b) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografën si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AKR, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga AKR, në të cilën theksohet se vendosja e Flamujve të AKR-së në Dardanë e kanë vërë në vende të zbrazëta, në sipërfaqe në të cilën nuk kanë mbuluar asgjë të subjekteve tjera politike të cilat garojnë për zgjedhje, në mënyrë të rregullt gjithmonë duke respektuar Ligjin dhe Kodin e Mirësjelljes. AKR dega në Dardanë në asnjë rast dhe në këtë rast nuk ka vendosur Flamuj mbi rrugë publike të trafikut në Dardanë. Dega e AKR-së në Dardanë menjëherë pas marrjes së ankesës nga LVV, kanë shkuar në vendin e supozuar nga LVV, ku kanë bërë fotografi me të cilat dëshmohet qartë se nuk ka asnjë flamur të vendosur mbi rrugë publike të trafikut dhe se nuk ka pasur asnjëherë.

Po ashtu në përgjigjen në ankesë AKR, vlerëson se është e padrejtë kjo ankesë dhe se kërkon nga PZAP që ta hudh ankesën poshtë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se flamujt e subjektit të AKR janë vendosur mbi rrugë publike me ç'rast është në kundërshtim me 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP- së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik AKR ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Andaj vendosja e flamujve të subjektit politik AKR mbi rrugët publike e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se AKR, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime konkrete duke e larguar menjëherë flamujt e subjektit politik nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstaton se subjekti politik AKR në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë, prandaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) lidhur me 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 311/2013 më datën 25.10.2013.



**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*